

Reforma

në sistemin zgjedhor të Kosovës

Prishtinë 2010

PERSONELI:

Ismet KRYEZIU - *Drejtor Ekzekutiv*
Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*
Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*
Arsim GJINOVCİ - *IT & design*

3

PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE:

Kreshnik Basha - *Menaxher programi*
Driton SELMANAJ - *Asistent i programit*
Isuf ZEJNA - *Monitorues*
Besnik RAMADANAJ - *Monitorues*
Liridon SELMANI- *Monitorues*

PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE

Naim CAHANAJ - *Koordinator*
Ramadan KLISURICA - *Koordinator*

PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*
Esat MAZREKU - *Koordinator*

Përmbajtja

4

1. Hyre	5
2. Sistemi zgjedhor në Kosovë.....	5
3. Procesi i ankesave dhe parashtresave në procesin zgjedhor në Kosovë (KZAP-i).....	7
4. Raundi i Dytë - Balotazhi	9
4.1 Sistemi sipas votimit alternativ.....	10
5. Pragu Zgjedhor	11
6. Votimi me Kusht.....	12
7. Listat e Hapura.....	13
8. Pjesëmarrja e ulët në zgjedhje - mënyrat për tejkalim	15
9. Rekomandimet	18

1. Hyrje

Konsolidimi i demokracisë në Kosovë vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore për institucionet e Kosovës dhe shoqërinë e saj në përgjithësi. Rol themeltar në këtë drejtim do të luante organizimi i një procesi zgjedhor i bazuar në zgjedhje të lira të drejta dhe transparente si një nga elementet shumë të rëndësishme në sendërtimin e një demokracie të mirëfilltë.

Zgjedhjet e fundit lokale të organizuara në Kosovë në nëntor të vitit të kaluar, nxorën në pah një numër të madh problemesh dhe parregullsish që në përgjithësi dëmtuan imazhin e procesit zgjedhor dhe si rezultat nxorën nevojën për rishikimin e legjislacionit aktual.

Pas evidentimit të mangësive dhe parregullsive në zgjedhjet komunale, partitë politike në Kosovë, me rekomandime të faktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë, kanë iniciuar reformat zgjedhore, që konsistojnë në ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për zgjedhjet. Ky proces tanimë ka filluar dhe gjendet në fazën fillestare, mirëpo strukturat që janë të përfshira në këtë proces janë zotuar që reformat apo ndryshimet në legjislacionin për zgjedhjet do të përfundojnë dhe do të jenë të gatshme për zgjedhjet nacionale që priten të mbahen në vitin e ardhshëm.

Instituti Demokratik i Kosovës duke e parë rëndësinë e madhe të këtij procesi, ka bërë një hulumtim – analizë në vendet e rajonit dhe më gjerë, me qëllim që të nxjerr një politikë publike duke propozuar një numër rekomandimesh që do të sillnin ndryshime në legjislacionin aktual për zgjedhjet, me çka edhe do të eliminoheshin në masë të madhe parregullsitë dhe mangësitë që i kanë shoqëruar proceset e mëparshme zgjedhore.

2. Sistemi zgjedhor në Kosovë

Që nga zgjedhjet e para të mbajtura në Kosovën e pasluftës në vitin 2000 e deri në zgjedhjet e fundit të vitit 2009/2010, kohë pas kohe Kosova ka bërë disa ndryshime të pjesshme në sistemin e vetë zgjedhor. Megjithatë, për shkak të rrethanave politike dhe fazës së tranzicionit nëpër të cilin ka kaluar Kosova, këto ndryshime nuk kanë sjellë ndonjë avansim të madh në sistemin e saj zgjedhor. Këto ndryshime kanë pasur të bëjnë kryesisht me çështjet e listave (hapura/mbyllura) dhe çështje tjera më tepër të natyrës teknike. Sidoqoftë, tani kanë kaluar më tepër se dhjetë vite nga përfundimi i luftës dhe gati tri vite që nga shpallja e pavarësisë së saj, institucionet e vendit duhet të punojnë më shumë për konsolidimin e parimeve demokratike. Një ndryshim apo edhe përmirësim i mëtutjeshëm i sistemi zgjedhor do të ndikonte në rritjen e legjitimitetit demokratik dhe të përgjegjshmërisë së gjithmbarshme.

Ligji aktual përcakton një zonë zgjedhore

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë e përcaktojnë Kosovën si një zonë të vetme zgjedhor me sistem të përfaqësimit proporcional. Edhe pse në vete ngërthen një mori mangësish, sistemi proporcional në Kosovë nuk ka qenë asnjëherë temë për ndryshim në

mesin e aktorëve kryesor të zgjedhjeve dhe si e tillë nuk do të trajtohet as në këtë punim diskutues.

Kosova me më shumë zona



Megjithatë një çështje mjaft e diskutuar e që lidhet ngushtë me sistemin zgjedhor janë zonat zgjedhore. Përkundër përpjekjeve dhe insistimeve të vazhdueshme të shoqërisë civile që në Kosovë të krijohen më tepër zona zgjedhore, deri më tani një çështje e tillë nuk ka pasur sukses. Megjithatë, në

bazë të deklarimeve të entiteteve të ndryshëm politik në vend, tanimë ekziston një vullnet që në Kosovë të krijohen më shumë zona zgjedhore. Sidoqoftë, përkundër qarkullimit të disa ideve në lidhje me atë se si do të dukeshin zonat zgjedhore, akoma nuk ka pasur një konsolidim të një ideje të vetme dhe të qartë në këtë çështje.

Krijimi i zonave zgjedhore do të kishte përparësi të mëdha, ku më kryesorja do të ishte rritja e përfaqësimit të qytetarëve dhe ndërlidhja me e madhe në mes të deputetëve dhe qytetarëve. Me sistemin aktual zgjedhor, lidhja ndërmjet deputetëve dhe zgjedhësve të tyre është mjaft e dobët, për të mos thanë që nuk ekziston fare. Duke qenë se pretendojnë se kanë fituar vota në të gjitha komunat e Kosovës, deputetët nuk kanë krijuar ndonjë lidhje të veçantë me qytetarët e komunave ose të rajoneve prej nga vijnë ata. Për më tepër, kohëve të fundit kemi parë një vërshim të deputetëve drejt kryeqytetit, duke u shkëputur edhe fizikisht nga mundësia për ti ndier apo kuptuar problemet e komunave të tyre.

Sistemi aktual me një zonë të vetme zgjedhore po prodhon edhe efekte negative në aspekt të përfaqësimit të barabartë të komunave në Kuvendin e Kosovës. Ky sistem ka mundësuar që disa komuna të mos kenë fare deputetë në Kuvend, të kenë numër relativisht të vogël, apo ka raste edhe kur komuna të vogla kanë numër të madh të deputetëve në Kuvendin e Kosovës.

Prandaj institucionet e Kosovës duhet të marrin shumë në konsideratë çështjen e ndarjes së Kosovës në më shumë zona zgjedhore. Megjithatë, gjatë këtij procesi duhet të kihet parasysh disa gjëra: të ketë shpërndarje të barabartë të votuesve, të krijohen njësi kompakte zgjedhore, të mbulojë bashkësi të natyrshme dhe territor të pandërprerë. Në këtë aspekt, ndër problemet kryesore më të cilat do të përballet Kosova gjatë ndarjes së zonave zgjedhore do të jetë numri i zonave zgjedhore, madhësia e tyre, kompozimi i tyre, si dhe përfaqësimi i barabartë gjinor dhe etnik. Duke u nisur nga fakti se Kosova zgjedhjet e ardhshme do t'i ketë në pjesën e dytë të vitit të ardhshëm, dhe duke pasur parasysh që çdo ndryshim në ligjin zgjedhor duhet të bëhet gjashtë muaj para se të mbahen zgjedhjet, është shumë e vështirë të mendohet që Kosova do të arrijë që të gjej kompromis/zgjidhje për çështjet e lartpërmendura. Megjithatë përkundër presionit kohor dhe rrethanave tjera që eventualisht mund të paraqiten gjatë procesit të ndryshimit të Ligjit për Zgjedhjet, forcat politike dhe faktorët tjerë të përfshirë në këtë proces duhet ta ndryshojnë sistemin zgjedhor në Kosovë duke krijuar disa zona zgjedhore.

Më shumë zona edhe për nivelin lokal

Me qëllim të përfaqësimit më të drejt dhe më gjithëpërfshirës, ndarja eventuale në më shumë zona zgjedhore nuk duhet të aplikohet vetëm për nivelin qendrorë por ajo duhet të vlejë edhe për nivelin lokal.

Ligji aktual për zgjedhje lokale komunat i ka përcaktuar si zona të vetme zgjedhore. Praktika e deritanishme në vendin tonë ka treguar që ky sistem nuk është mjaft përfaqësues dhe gjithëpërfshirës. Andaj shihet si domosdoshmëri që edhe niveli lokal përkatësisht komunat të ndahen në disa zona zgjedhore me qëllim që përfaqësimi të ketë një shtrirje më të gjerë gjeografike dhe më balancuese brenda hapësirave të komunave.

3. Procesi i ankesave dhe parashtrave në procesin zgjedhor në Kosovë

KZAP-i



Me qëllim të trajtimit të ankesave (apelimeve) eventuale që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, ligji zgjedhor në Kosovë ka paraparë institucionin e Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (KZAP) si organ i pavarur kompetent për tu marrë me këtë çështje.

Me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës formimi i këtij institucion i atribuohet si e drejtë ekskluzive kryetarit të Gjykatës Supreme i cili emëron anëtarët e KZAP-it nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme dhe gjykatave të qarkut.

Problemet dhe sfidat e KZAP-it

Vonesa në ndarjen e buxhetit nga ana e institucioneve të Kosovës, mungesa e transparencës, mungesa e hapësirave fizike të nevojshme për punë, mungesa e personelit të mjaftueshëm dhe çfarë është më e rëndësishmja mos gatishmëria e Komisionit Qendror Zgjedhor për të respektuar vendimet e këtij organi kanë qenë disa nga faktorët të cilët e kanë penguar funksionalizimin dhe integritetin e këtij institucioni.

Ligji zgjedhor në Kosovë ka përcaktuar kompetencat e këtij organi duke i dhënë të drejtë që vendimet e tij të jenë të detyrueshme për KQZ-në nëse nuk janë apeluar paraprakisht në Gjykatën Supreme.

Neni 118.5 i Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme shprehimisht thotë:

“Vendimi i KZAP-it është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar sipas këtij ligji ose Kushtetutës parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe gjykata më e lartë përcakton ndryshe”.

Praktika zgjedhore në Kosovë gjatë zgjedhjeve lokale të vitit të kaluar ka nxjerrë në pah brishtësinë e integritetit të KZAP-it karshi KQZ. Rasti konkret ishte gjatë procesit të fundit elektoral në zgjedhjet lokale, ku KZAP-i pas shqyrtimit të 43 ankesave të partive politike për balotazhin e 13 dhjetorit, kishte udhëzuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që të marrë vendim për rivotim në komunën e Prizrenit, Gjilanit e Lipjanit. Ky udhëzim ishte dhënë për shkak të numrit të madh të ankesave që ka marrë KZAP-i për këto tri komuna.

Përkundër që në bazë të ligjit zgjedhor në Kosovë një kompetencë për të marrë vendime për ankesat e subjekteve të caktuara që lidhen me procesin zgjedhor i njihet KZAP-it, KQZ pas marrjes së vendimeve të KZAP-it kishte kërkuar edhe njëherë nga ky institucion për të dhënë sqarime mbi dispozitivin e këtij vendimi, duke e shndërruar këtë organ në një institucion interpretues dhe këshillëdhënës e jo në një institucion i cili merr vendime në bazë të kompetencave të garantuara me dispozita ligjore.

Megjithatë KZAP-i është akuzuar edhe nga disa organizatat vendore dhe ndërkombëtare se në disa raste nuk ka ushtruar pushtetin e tij sipas Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, që të udhëzoj KQZ-në që të përsërit votimin në 15 vend-votime, ku ishin konstatuar parregullsi. Andaj, votuesit ishin privuar nga mundësia për të shprehur vullnetin e tyre për shkak të mos-mirësjelljes së stafit të vend-votimit¹.

Përvojat e rajonit

Nisur nga praktikat e vendeve të rajonit del se forma të tilla të ngjashme me Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia nuk ekzistojnë në ato vende. Në Republikën e Maqedonisë çështja e ankimit është e rregulluar në formë krejtësisht të ndryshme.

Sipas nenit 149 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Maqedonisë parashihet që:

Secili zgjedhës, të cilit i është cenuar e drejta zgjedhore në procedurën e zbatimit të votimit, mund të paraqesë kundërshtim pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, kurse për zgjedhjet lokale pranë komisionit të qytetit të zgjedhjeve, ose komisionit komunal të zgjedhjeve në afat prej 24 orësh².

Sipas këtij neni e drejta për të apeluar për një çështje të caktuar që e prek procesin zgjedhor fillimisht duhet të bëhet pranë organeve të cilat janë të përcaktuara për zbatimin e zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë. Mirëpo kundër aktvendimeve të këtyre organeve mund të paraqitet ankesë pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, në afat prej 48 orësh pas pranimit të aktvendimit. Pra nga ky kontekst del se organet të cilat kanë për obligim organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve siç janë: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisionet komunale të zgjedhjeve, dhe Komisioni i Qytetit paraqesin shkallën e parë të cilat i shqyrtojnë ankesat e caktuara, ndërsa Gjykata Supreme paraqet shkallën e dytë, vendimet e së cilës janë përfundimtare dhe të pa apelueshme.

Po ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë kjo çështje është përcaktuar mjaft qartë në

¹ ENEMO- Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit në Kosovë për Zgjedhjet komunale 2009.

² Kodi Zgjedhor i republikës së Maqedonisë ,

<http://makemigration.readyhosting.com/upload/izborenzakonikAL.pdf>

Kodin Zgjedhor të këtij shteti, i cili dallohet nga praktikat Kosovare për nga forma dhe mënyra e rregullimit të kësaj çështjeje.

Sipas këtij Kodi : “Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së (Komisioni Zonal për Administrimin Zgjedhor), që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

Kundër vendimit të KQZ-së, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 3 ditë nga shpallja e këtij vendimi”³

Po ashtu neni 145 parasheh: 1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor⁴.

Si konkluzion del se edhe në Republikën e Shqipërisë kjo çështje rregullohet sipas parimit të dy-shkallëshmërisë, ku fillimisht ankesat e subjekteve të caktuar mund t’i drejtohen KQZ-së si shkallë e parë, ndërsa Gjykatës së Apelit, si shkallë e dytë, vendimet e të cilit janë vendimtare.

Fuzionimi i KZAP-it në Gjykatën Supreme?

Nga shembujt e lartë përmendur dhe nga problemet e evidentuar në sistemin zgjedhor dhe procesin e fundit elektoral në Kosovë, mund të nxjerrim konkluzionin se forma dhe mënyra e ankimit në vendin tonë duhet të rishikohet sepse trupat ankimor sipas modelit ekzistues në Kosovë, janë karakteristikë e vendeve në tranzicion .

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa mund të propozohet që me plotësimin e Ligjit për Zgjedhje të shuhet, pra ky organ të fuzionohet në Gjykatën Supreme ose mund të kalojë në kompetencë të plotë të Gjykatës Supreme, përkatësisht, të degës administrative.

4. Raundi i Dytë - Balotazhi

Raundi i dytë i votimit apo siç njihet në praktikat elektorale me emrin “Balotazhi” është forma e cila aplikohet në rastet kur në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e ka marrë shumicën e nevojshme të votave 50+1, atëherë në balotazh votohet për dy kandidatë të cilët në rrethin e parë kanë marrë më së shumti vota. Kandidati i cili fiton shumicën e votave të në rrethin e dytë zgjidhet Kryetar i Komunës apo President i Republikës (nëse Presidenti zgjidhet drejtpërdrejt nga populli).

Republika e Kosovës përmes legjislacionit të saj përkatësisht Ligjit për Zgjedhjet lokale e ka pranuar formën e lartpërmendur me rastin e zgjedhjeve për kryetar komune.

³ Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë - http://www.osce.org/documents/pia/2009/06/14076_sq.pdf.

⁴ Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë - http://www.osce.org/documents/pia/2009/06/14076_sq.pdf.

Shtetet fqinje pa balotazh!



Republika e Shqipërisë, për dallim nga Kosova, përmes Kodit të saj zgjedhor nuk ka paraparë fare rreth të dytë zgjedhor por sipas nenit 166 të këtij Kodi:

“Kryetar bashkie ose komune zgjedhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse”⁵.

Megjithatë jo edhe shumë më ndryshe këtë qështje e ka rregullar edhe shteti tjetër fqinjë, Republika e Maqedonisë. Sipas Kodit Zgjedhor të këtij shteti në rrethin e parë të votimit për kryetar të komunës mund të zgjedhin një kandidat, i cili ka marrë shumicën e votave të zgjedhësve që kanë votuar, në qoftë se në zgjedhjet kanë dalë një e treta e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve të evidentuar në ekstraktin e Listës së Zgjedhjeve për komunën përkatëse. Në të kundërtën ka paraparë organizimin e rrethit të dytë i cili funksionon në mënyrë të ngjashme me vendin tonë, ku kryetar i komunës zgjidhet ai kandidat i cili ka marrë numër më të madh votash.

Si e metë e organizimit të rrethit të dytë të zgjedhjeve (Balotazhit) është konstatuar kostoja e lartë buxhetore, dhe lodhja e votuesve. Në anën tjetër forma e tillë vlerësohet si mjaft demokratike me qëllim të zgjedhjes së kandidatit me legjitimitet më të fuqishëm.

4.1 Sistemi sipas votimit alternativ

Shembull i aplikimit të këtij sistemi janë Australia e largët dhe pjesërisht edhe Britania e Madhe, ku qëllimi primar i aplikimit të këtij sistemi është mënjanimi i organizimit të raundit të dytë të zgjedhjeve. Ky sistem ka paraparë të drejtën e votuesve që të rendisin kandidatët në mënyrë të preferencës, që do të thotë nëse në një listë janë pesë (5) kandidatë, votuesi do të votojë për secilin kandidat sipas preferencës me numra nga një(1) deri në (5).


Sipas këtij sistemi nëse nuk merr shumicën e votave preferenca e parë, kandidati i cili mbetet i fundit nga kjo listë sipas votave të votuesve eliminohet, duke ja bartë votat e preferencës së dytë kandidatëve tjerë. Në rast se përsëri nuk fiton asnjë kandidatë atëherë eliminohet edhe kandidati tjetër që ka ngelur me numrin më të vogël të votave. Kjo formë vazhdon derisa një kandidat merr më shumë se 50% të votave dhe më pas shpallet fitues.

Përparësitë e këtij sistemi vlerësohen të jenë: moskrijimi i koalicioneve të panatyrshme pas raundit të parë zgjedhor, kostoja e procesit zgjedhor. Ndërsa mangësitë apo disavantazhet mund të jenë: sistemi më i komplikuar për votuesit, mundësia e manipulimit etj.

Ky sistem mund të jetë një nga format që mund të aplikoj edhe vendi ynë me qëllim të mënjimit të raundit të dytë apo në disa raste edhe raundit të tretë zgjedhor.

⁵ Kodi Zgjedhor i Shqipërisë – Neni 166, http://www.osce.org/documents/pia/2009/06/14076_sq.pdf.

5. Pragu Zgjedhor



Në sistemet proporcionale të përfaqësimit, pragu zgjedhor paraqet një dispozitë me të cilën përcaktohet minimumi i përqindjes së votave që duhet fituar një subjekt politik (koalicion i partive politike, një parti e vetme politike, nismat qytetare apo një kandidat i pavarur) për të siguruar të drejtën e pjesëmarrjes në ndarjen e ulëseve në parlament. Lartësia e përqindjes së këtij pragu zgjedhor është e përcaktuar me Ligjin për Zgjedhje apo në Kodin Elektorale të

çdo shteti dhe ajo ndryshon nga shteti në shtet. Shumica e shteteve kanë një prag zgjedhor prej pesë përqind (5%), siç është rasti i Gjermanisë, Polonisë, Kanadasë, apo pragu zgjedhor prej katër përqind (4%) në Norvegji. Prag të ulët zgjedhor në sistemin e tyre elektorale kanë përzgjedhur Izraelitët me vetëm dy përqind (2%), kurse shteti ku pragu zgjedhor është më i lartë dhe arrin vlerën prej dhjetë përqind (10%) është Turqia. Nga ana tjetër shtetet si Portugalia, Finlanda, Holanda edhe pse kanë sistem zgjedhor me përfaqësim proporcional, nuk kanë të përcaktuar fare prag zgjedhor.

Këshilli i Evropës rekomandon prapun jo më shumë se 3 %

Nëse analizohen kodet zgjedhore të shteteve të rajonit del që një prag zgjedhor prej pesë përqind (5%) kanë Kroacia dhe Serbia, kurse Sllovenia prapun e përcaktuar zgjedhor e ka në vlerë prej katër përqind (4%). Prag pak më të ulët zgjedhor ka Bosnje dhe Hercegovina me vlerë tre përqind (3%). Në Kodin Zgjedhor të Shqipërisë është bërë një kombinim, kështu që për partitë politike pragu zgjedhor është përcaktuar të jetë tre përqind (3%), ndërsa për koalicionet e partive politike pesë përqind (5%). Maqedonia nga ana tjetër, në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk ka të përcaktuar fare prag zgjedhor.

Sipas Rezolutës 1547 (2007) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, për vendet me demokraci të zhvilluar rekomandohet që pragu zgjedhor të mos jetë më i madh se tre përqind (3%).

Kuvendi i Kosovës, me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të miratuar në vitin 2007 parashikoi një rritje të pragut zgjedhor prej pesë përqind (5%).

Neni 111, pika 2 - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës:
111.2 Njëqind (100) vendet e Kuvendit të përshkruara në nenin 111.1 (a) ndahen sipas mënyrës në vijim dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme që i ka fituar secili subjekt politik: a) në mesin e subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera jo shumicë dhe në mesin e subjekteve politike të cilat nuk përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet jo shumicë të cilat kanë fituar së paku pesë për qind (5%) nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme në zgjedhjet për Kuvend;

Pragu i lartë zgjedhor mundëson që mandatet në trupin përfaqësues të ndahen nga një numër më i vogël i partive të cilat kanë arritur rezultate të mira në zgjedhje dhe kështu

siguron që ky trup përfaqësues më lehtë të krijojë Qeverinë, t'i jap asaj përkrahjen dhe t'i pranojë propozimet e saj, gjë që siguron një sistem të qëndrueshëm politik.

Ngritja e pragut zgjedhor në 5%, në vitin 2007 u arrit pas një konsensusi në mes të partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës. Ky prag i lartë zgjedhor ua pamundëson pjesëmarrjen në Kuvend një pjese të konsideruar të partive të vogla, siç ishte rasti me pamundësinë e fitimit të ulëseve për partinë ORA në vitin 2007, edhe pse ajo kishte fituar 4.2% të votave dhe ishte treguar mjaft aktive gjatë mandatit paraprak

Nevoja për debat

Me përcaktimin për një prag të lartë zgjedhor nuk arrihet që të gjitha votat të jenë të përfaqësuara në Kuvend, prandaj ekziston rreziku që një pjesë e komunitetit apo interesave të mbesin pa përfaqësim adekuat. Një gjë e tillë sjell deri te shuarja e partive të vogla politike apo i detyron këto parti të hyjnë në koalicione parazgjedhore në mënyrë që të krijojnë mundësi më të mëdha për një rezultat të favorshëm zgjedhor. Prandaj, duke marrë parasysh synimet e klasës politike në Kosovë drejt ndërtimit të institucioneve me demokraci të zhvilluar, si dhe parimin për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë, një ulje e pragut zgjedhor do të duhej të sillet në debat publik dhe të merret në konsideratë.

6. Votimi me Kusht



Votimi me kusht është një praktikë që shpesh përdoret në mjediset pas konflikteve për t'iu dhënë votuesve mundësinë të votojnë edhe pse ai/ajo nuk është në listën e votuesve ku ai/ajo pretendon se ka të drejtë të votoj. Kjo formë e të votuarit nuk është shumë e zakonshme në shtetet të cilat kanë sistemin e konsoliduar

elektoral dhe të cilat kanë një traditë në organizimin e zgjedhjeve sipas standardeve të avancuara demokratike. Votimi me kusht është formë e votimit në të cilën votuesit e japin votën e tyre dhe e cila fillimisht duhet të futet në një zarf për t'u verifikuar nga një komision suprem dhe pastaj të vendoset nëse do të numërohet apo jo.

Votimi me kusht, përvojë e shteteve pas-konflikteve

Ky lloj votimi, është i zakonshëm në ato vende të cilat kanë probleme me listat e votuesve, regjistrin civile dhe regjistrimin e popullsisë. Formë e tillë e të votuarit mundësohet në vendet pas konflikteve si për shembull në Kosovë dhe Irak, por ka edhe raste në disa forma të tjera dhe në masë shumë të kufizuar, praktikohet edhe në shtete të cilat njihen si djep i demokracisë për shembull në disa shtete federale të SHBA-së⁶.

Votimi me kusht, sjell probleme për procesin zgjedhor

Votimi me kusht ka shumë mangësi dhe zakonisht vonon shpalljen e rezultateve të numërimit dhe paraqet një rrezik potencial për uljen e besimit në tërë procesin⁷.

⁶ Ligji Elektoral i Shtetit të Floridas.

⁷ Ligji Elektoral i Shtetit të Floridas.


Për shkak të kontrollit që duhet t'i bëhet secilës votë veçanti, me qellim të shmangies së votimit të dyfishtë⁸, kjo formë e votimit ka rezultuar me një kosto të lartë buxhetore. Në Kosovë gjatë tërë procesit zgjedhorë ka pas dyshime, se mbase votimi me kusht mundë të keqpërdoret në qendrat e numërimit, duke vendosur sipas preferencave të atyre që bëjnë numërimin dhe verifikimin e këtyre votave.

Eliminimi i votave me kusht

Në Kosovë gjatë zgjedhjeve të fundit, votimi me kusht i ka shtuar sfidat e këtij procesi për të arritur që procesi të jetë efektiv. Nga debatet e organizuara me qytetarë dhe entitete të përfshirë në këtë proces nga Demokracia në veprim, ka dal si rekomandim i përgjithshëm se duhet të eliminohet kjo formë e votimit⁹.

Duke i marr parasysh të gjitha këto mangësi, është e rëndësishme që ndermirën veprimet pasuese: Ligji i ardhshëm zgjedhor të mos e parashoh këtë formë të votuarit. Përpjekjet për t'iu mundësuar secilit qytetar të votoj aty se ku pretendon ai/ajo, do të duhej të orientoheshin drejt pastrimit të listave të zgjedhësve dhe edukimit të tyre. KQZ në bashkëpunim me media dhe shoqërinë civile do të mundë të ndërmerrnin një fushatë të edukimit të zgjedhësve para se të mbahen zgjedhjet e ardhshme, këtu qytetarët do të mund të njoftoheshin se si duhet të veprojnë në mënyrë që të mos kenë probleme me listën e votuesve në ditën e votimit!

7. Listat e Hapura



Sistemi zgjedhor me lista të hapura vlerësohet si formë më demokratike e zgjedhjeve dhe përgjegjësisë së të zgjedhurve, pasi u mundëson votuesve që të zgjedhin kandidatin, duke ia mohuar për këtë qeshtë pushtetin partisë ose liderit të saj. Sistemi me lista të hapura i mundëson votuesit që të votojë për kandidatin, njëkohësisht dhe për

partinë, përderisa sistemi me lista të mbyllura të drejtën e zgjedhjes së kandidatit ia jep partisë.

Në vendet me demokraci të zhvilluar, sistemi i votimit me lista të hapura ka rritur përgjegjshmërinë e të zgjedhurve dhe ndikimin e qytetarëve në qeverisje. Ky sistem po ashtu zvogëlon rrezikun e forcimit të grupeve klanore brenda partive.

Një studim i Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Elektorale (IFES), të publikuar vitin e kaluar, paraqet një varg përfitimesh nga sistemi me lista të hapura. Përkrahësit e këtij sistemi vlerësojnë se kjo është një nga format për shmangur tiraninë e udhëheqësit të partisë, sigurimin e një niveli më të lartë të demokracisë, si dhe cilësi më të mirë të qeverisjes dhe rritje të llogaridhënies¹⁰.

⁸ ENEMO, International Observation Mission to Kosovo Municipal Elections 2009. Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Preliminare. Prishtinë, nëntor 2009.

⁹ www.demokracianeveprim.org.

¹⁰ IFES - election issues, april 2009

Eksperimentet me lista (të hapura / mbyllura)

Në Kosovë, që nga pas lufta, ka pasur debat lidhur me gjetjen e mënyrës më të mirë të votimit. Në zgjedhjet e para lokale të mbajtura në Kosovë ishte implementuar sistemi zgjedhor me lista të hapura, ndërkohë që në zgjedhjet e radhës, kjo formë ishte ndryshuar.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2007 ishte implementuar sistemi me lista “gjysmë të hapura”, apo thënë ndryshe, brenda listës së hapur, ka pasur mangësi, ose diskriminim pozitiv. Ky sistem ka qenë shumë përfitues për të parin e listës, pasi çdo votë, për partinë, ka shkuar automatikisht për prijësin e listës. Kjo mënyrë është vlerësuar si jo e drejtë, pasi votat automatike nuk konsiderohen legjitime dhe demokratike.

Dallimi që është vërejtur nga sistemi me lista të hapura nga ai me lista të mbyllura është edhe thjeshtësia e votimit. Ky element e kishte favorizuar sistemin me lista të mbyllura, pasi kishte pasur më pak konfuzion tek votuesi, përderisa tek listat e hapura, kishte pasur më shumë vota jo valide. Mirëpo, nga zgjedhjet e fundit problemet e lartcekura nuk ishin theksuar asnjëherë. Po ashtu, informimi me kohë, do të ndikonte në edukimin e votuesve. Një argument tjetër që njohësit e procesit zgjedhor e përmendin, është edhe kosto më e ulët e sistemit me lista të mbyllura, kjo pasi ka vetëm një listë (për partinë).

Listat e hapura nuk e vonojnë votimin

Çështja se listat e hapura mund të marrin më shumë kohë gjatë procesit të votimit, ka qenë pjesë e fokusit edhe në analizën e koalicionit të OJQ-ve “Demokracia në Veprim”, “Analizë e zgjedhjeve: Trendet dhe mësimet e nxjerra”, të vitit 2007.

Mbajtja e tri palë zgjedhjeve njëherazi, dy me mundësi të votimit për dhjetë persona nga listat e hapura ngritën frikën se procesi votues mund të zgjaste shumë. KQZ-ja mbajti një simulim të zgjedhjeve dhe vlerësoi se koha e nevojshme për të votuar ishte rreth 10 minuta për një votues. Vëzhguesit e ‘Demokracisë në Veprim’ matën kohën sa zgjati procesi i votimit me anë të mostrës së rastësishme dhe vlerësuan që për 17.6% të votuesve koha e nevojshme për të votuar ishte më pak se 5 minuta; nga 5-8 minuta për gjysmën e votuesve mori; dhe përafërsisht 20% të votuesve u është nevojitur më shumë se 10 minuta. Kjo ishte koha e nevojshme për të hyrë në vendvotim dhe të dalin, duke mos llogaritur pritjen¹¹.

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme përcakton sistemin proporcional, ku votuesi ka të drejtën e votimit edhe të kandidatit, edhe të partisë¹². Po ashtu edhe Ligji për Zgjedhjet Lokale përcakton standardin e njëjtë, ku votuesi voton një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik¹³.

¹¹ Ligji Elektoral i Shtetit të Floridas.

¹² Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 110, pika 4.

¹³ Ligji për Zgjedhjet Lokale, neni 7, pika 4.

Përvojat evropiane

Shtetet evropiane që kanë sistem të votimit me lista të hapura janë Austria, Çekia, Estonia, Lituania, Holanda, Polonia, Sllovenia, Kroacia, Suedia dhe Shqipëria.

Në Kodin e zgjedhjeve në Shqipëri paraqitet qartë mënyra e votimit. Neni 67 thotë se *1. Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumëmemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar komune apo bashkie dhe lista e kandidatëve për këshillat vendore regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ*¹⁴.

Kroacia, po ashtu ka sistem proporcional me lista të hapura. Neni 2 i Ligjit për Zgjedhjet Parlamentare i mundëson votuesve votimin e kandidatëve që dëshirojnë¹⁵.

Përparësitë e këtij sistemi vlerësohen të jenë:

- Ndikim më i madh i qytetarëve në përzgjedhjen e deputetëve,
- Rritja e legjitimitetit të të zgjedhurve,
- Përzgjedhje e kandidatit nga qytetari, e jo nga partia ose lideri.

Mangësitë:

- Rrezikon zvogëlimin e përfaqësimit regjional
- Rrezikon zvogëlimin e mundësisë së përfaqësimit të komuniteteve dhe gjinive.

Duke pasur parasysh modelet dhe funksionimin e të dyja sistemeve, si dhe sfidat që demokracitë e reja ballafaqohen, sistemi i votimit me lista të hapura do të ishte forma më e përshtatshme për shtetin e Kosovës dhe çdo shteti që ka si orientim dhe përkushtim zhvillimin e demokracisë. Edhe pse në Kosovë gjatë periudhës dhjetëvjeçare ka pasur eksperimente të sistemit zgjedhor, votimi me lista të hapura do të luftonte krijimin e klaneve, sundimin e partive nga liderët dhe varshmërinë e të tjerëve tek liderët.

8. Pjesëmarrja e ulët në zgjedhje – mënyrat për tejkalim

Çështja e pjesëmarrjes së ulët në votime ka marr një theksim të veçantë në diskutimet publike që kanë pasuar mbas zgjedhjeve të fundit komunale në Kosovë; kjo për arsye të përqindjes së ulët të daljes dhe trendit rënës krahasuar me zgjedhjet paraprake. Rënia e numrit të votuesve në zgjedhje është lidhur shpesh me problemet themelore të demokracisë. Kështu ky trend i ulët në ushtrimin e të drejtës themelore mund të jetë pjesë e deficitit demokratik të shoqërisë në Kosovë e cili ka reflektimet e saja në pamundësinë e krijimit të një sistemi demokratikë të mirëfilltë. Sidoqoftë, arsyet e një dalje të ulët në votime mund të jenë të shumta dhe jo domosdoshmërisht të lidhura me

¹⁴ Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

¹⁵ Ligji për zgjedhjet, i amendamentuar në vitin 2007.

zgjedhjet. Në të shumtën e rasteve ky fenomen është i ndërlidhur me zhvillimin shoqërorë dhe ekonomik të një vendi. Dalja e ulët në zgjedhje rëndomtë mund të shihet si pamundësi për të ndikuar në agjendat politike apo jetën publike në përgjithësi, dhe të reflektohet (ashtu edhe si ka ndodhur) në përqindjen e ulët të pjesëmarrjes së tij në të dy nivelet e zgjedhjeve.

Derisa qytetaret kanë nevojë më të mëdha jo vetëm sa i përket transparencës dhe çështjeve politike por edhe plotësimin e nevojave të përditshme të tyre; partitë tona politike kanë vështirësi që të ju ofrojnë atyre një produkt të mirëfilltë. Dhe në këto raste edukimi qytetar i cili shumë përfillet nuk është i mjaftueshëm, nëse qytetaret nuk shohin se shërbimi i të zgjedhurve të tyre është përmirësuar dhe ka si pasojë humbjen e besimit në proceset demokratike.

Disa ndër arsyet për mos dalje në votime mund të jenë:

- Mungesa e besimit në entitetet politike dhe në kandidatët të cilët partitë politike i kanë propozuar për shkak të mos ekzistimit të demokracisë brenda partiake. Në disa raste mungesa e kësaj demokracie të brendshme e pamundëson ardhjen në shprehje të personaliteteve që mund të nxisin jo vetëm interesimin qytetar për atë entitet por edhe të ju ofrojnë atyre 'alternativën' e dëshiruar. Në disa parti politike mungesa e demokracisë së brendshme ka rezultuar edhe me plasaritje të cilat e kanë 'shkundur' një pjese të elektoratit nga jeta politike sikurse që është rasti me zgjedhjet e fundit kur kandidatet për kryetar komune kanë marr më tepër vota se entiteti që ata kanë përfaqësuar¹⁶.

- Nivel i ulët i llogaridhënies së të zgjedhurve ndaj votuesve të tyre i cili vihet në shprehje me mungesën e përgjegjësisë ndaj qytetarit. Në të shumtën e rasteve ata (të zgjedhurit) nuk kanë prekje me bazën apo regjionet dhe siç është cekur në disa debate publike¹⁷ (të mbajtura me organizimin e KDI-së¹⁸ mungesës së iniciativave për bashkëpunim të ndërsjellë. Shpeshherë kjo është arsyetuar me domosdoshmëri për ndryshimin e sistemit zgjedhor përkatësisht ndarjen e Kosovës në disa zona zgjedhore, sepse sipas tyre ekzistimi i një zone ndikon që deputetët të humbin prekjen me qytetarin dhe bëhen të pandjeshëm ndaj nevojave të regjioneve të cilat ju kanë besuar votën.

- Mungesa e pjekurisë politike dhe e debateve të mirëfillta e cila shprehet me qasje jo praktike dhe jo kreative në jetën politike Kosovare. Në disa raste entitetet politike janë më tepër të preokupuara që të sfidojnë konkurrentet e tyre politike se sa të ofrojnë zgjidhja praktike nga të cilat do të përfitonin qytetarët.

- Mungesa e një kulture politike dhe vetëdijesimi të elektoratit i cili është mësuar nga e kaluara që duhet të pranoj çdo gjë të servuar dhe mendon se obligimi i tij përfundon me rastin e votimit. Mungesa për të luftuar më tepër brenda entiteteve politike që ju takojnë apo për të cilat kanë preferenca me qëllim të eliminimit të atyre që dështojnë të ofrojnë shërbime të mirëfillta ndaj qytetareve/votuesve.

¹⁶ <http://www.kqz-ks.org/>.

¹⁷ Debate i mbajtur me 17 Shtator në mes parlamentareve të regjionit të Prizrenit dhe anëtarëve të Asamblesë Komunale të Dragashit me shoqërinë civile.

¹⁸ KDI - Instituti Demokratik i Kosovës

Me qëllim që të preken çështjet e lartpërmendura duhet të krijohet një mekanizëm i cili i detyron entitetet politike të jenë më përgjegjëse ndaj qytetarëve. Ky mekanizëm mund të jetë edhe përcaktimi i pragut të ulët për dalje në votime i cili duhet të plotësohet me qëllim që zgjedhjet të cilësohen si legjitime. Nga disa debate të cilat ishin të organizuara nga shoqëria civile në Kosovë dhe raportet e tyre¹⁹ është përmendur që ky prag duhet të përcaktohet.

Është mendim i Institutit Demokratike të Kosovës (KDI) se ky prag duhet të jetë 40% për zgjedhjet kombëtare dhe vendore me kusht që listat e votuesve të azhurnohen rregullisht. Përcaktimi i këtij pragu mund të mbështetet me mekanizmat detyrues apo stimulues siç është rasti shtetet e ndryshme sikurse që janë²⁰ Australia, Austria, Luksemburgu, Greqia, Belgjika, Turqia, Italia, Qiproja, Holanda, etj

Argumentet e përdorura në favor të votimit të obliguar janë:

- a) Votimi është obligim i ngjashëm me obligimet tjera qytetare (si p.sh. Pagesa taksave, arsimimi i obliguar, etj);
- b) Parlamenti dhe asamblatë komunale reflektojnë më saktë 'vullnetin e popullit'.
- c) Qeveria e ka parasysh që përball vetes e ka një elektorat më të gjerë gjatë menaxhimit të buxhetit dhe bërjes së politikave publike;
- d) Kandidatet koncentrohen që tërë energjitë e tyre ti fokusojnë në çështje me interes për qytetarët se sa ti inkurajojnë ata të dalin në votime;


¹⁹ Tetor 2009 - Lëvizja Fol / Botimi Dalja ne Zgjedhje dhe Legjitimiteti

²⁰ January 2006 - Election Systems and Monitoring / Tim Evans Publication - Compulsory Voting in Australia

9. Rekomandime

18

- Me qëllim të përfaqësimit më të drejtë të qytetarëve të Kosovës në institucionet përfaqësuese, Kosova nga një zonë e vetme (unike) zgjedhore, duhet të ndahet në disa zona zgjedhore;
- Sistemi me shumë zona zgjedhore duhet të aplikohet edhe në nivelin komunal, duke i ndarë komunat në disa zona zgjedhore.
- Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP-i) duhet të shuhet apo të fuzionohet në Gjykatën Supreme ose mund të kaloj në kompetencë të plotë të Gjykatës Supreme, përkatësisht, të degës administrative;
- Me qëllim të eliminimit të organizimit të raundit të dytë zgjedhor (Balotazhit), Kosova mund ta aplikoj Sistemin e Votimit Alternativ;
- Të krijohen mundësitë për të votuar për të gjithë personat me të drejtë vote, të bëhet pastrimi i listave dhe edukimi e votuesve, me qëllim që Votimi me Kusht të hiqet nga Ligji dhe praktika jonë elektorale;
- Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes sa më të madhe të partive politike dhe përfaqësimit më të gjerë në Kuvendin e Kosovës, pragu zgjedhor duhet të ulet nga 5% në 3 % për partitë politike ndërsa për koalicionet të mbetet 5%.
- Kosova duhet të aplikoj sistemin i votimit me lista të hapura sipas parimit një person një votë, duke përjashtuar mundësinë që të përfitoj prijësi i listës, pasi votat e tilla automatike nuk konsiderohen legjitime dhe demokratike.
- Me qëllim që zgjedhjet të konsiderohen legjitime propozohet që pragu i daljes në votime të jetë në 40% i Listës Finale të Votuesve e cila rregullisht azhurnohet



Reform

of the Kosova Electoral System

Prishtina 2010

 **KDI**
Instituti Demokratik i Kosovës
Kosova Democratic Institute

Summary

20

1. Introduction.....	21
2. Electoral System in Kosova.....	21
3. Election Complaints and Appeals Procedures in Electoral Process of Kosova (ECAC).....	23
4. Second Round of Mayoral Elections	25
4.1 Alternative Voting System.....	24
5. Elections threshold.....	27
6. Conditional Voting.....	28
7. Open Lists.....	29
8. Low Election turnout – the ways to overpass.....	32
9. Recommendations	34

1. Introduction

Democracy consolidation in Kosovo continues to remain one of the main challenges for Kosovo's institutions and society in general. Crucial role towards this direction would play the organisation of an electoral process based on free, fair and transparent elections as one of important elements of a real democracy building.

21

The latest local elections held in November last year have brought a big number of problems and irregularities, which in general have deteriorated the image of electoral process and, as such, the need of current electoral legislation's review was initiated.

Upon identifying shortcomings and irregularities of municipal elections, local and international factors have recommended political parties to initiate election reforms, consisting of changing and amending the Law on Elections. This process has already commenced and it is at initial phase. The involved structures have pledged to complete reforms or electoral changes before national elections, which are planned to be organised next year.

